



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, Trupi Gjykses më 25 korrik rrëzoi një kërkesë të ekipeve të Mbrojtjes për nxjerrje të informacionit të mëtejshëm në lidhje me një ndihmësprokuror i cili më parë kishte punuar në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara. Mbrojtja kishte shprehur shqetësim lidhur me një konflikt të mundshëm interesash me dyshimin se peroni në fjalë mund të ketë pasur qasje në informacion të privilegjuar në Njësinë e Paraburgimit. Trupi Gjykses konstatoi se Administratorja dhe Prokuroria i kishin dhënë Mbrojtjes informacion të hollësishëm lidhur me punësimin dhe rolin konkret të mëparshëm të atij personi dhe lidhur me hapat e ndërmarrë për parandalimin e konfliktit të interesave.

Më 25 korrik u publikua një vendim lëshuar në maj të këtij viti lidhur me një kërkesë të Prokurorisë për pranim provash. Trupi Gjykses e miratoi mocionin pjesërisht e në të njëjtën kohë nuk pranoi disa nga provat materiale sepse Prokuroria nuk mund të provonte arsye të vlefshme pse kërkesa nuk ishte paraqitur më herët dhe për shkak se provave materiale u mungonte autenticiteti. Në vendimin e vet Trupi Gjykses nënvizoi se Mbrojtja do të mund të paraqesë parashtrime mbi provat materiale të pranura lidhur me peshën dhe vlerën e tyre provuese dhe të ngrejë kundërshtime lidhur me përmbajtjen e tyre. Mbështetja ose mosmbështetja e Trupit Gjykses në provat e pranura dhe pesha e tyre përcaktohen nga gjykatësit gjatë vlerësimit prej tyre të provave të pranura në fund të çështjes gjyqësore.

Më 11 gusht, Trupi Gjykses miratoi pjesërisht një kërkesë të Mbrojtjes së Thaçit për apelimin e një vendimi të Trupit Gjykses. Pas dhënies së dëshmisë prej një dëshmitari të Prokurorisë, Mbrojtja kishte kërkuar të paraqiste si prova deklaratat e të njëjtit dëshmitar. Në atë kohë Trupi Gjykses e rrëzoi kërkesën dhe e udhëzoi Mbrojtjen e Thaçit t'i paraqiste deklaratat në një fazë të mëvonshme. Sidoqoftë kur Mbrojtja paraqiti kërkesën sipas sugjerimit, Trupi Gjykses e rrëzoi kërkesën duke konstatuar se deklaratat duhej të paraqiten sipas rregullave konkrete të Rregullores për deklaratat me shkrim të dëshmitarëve. Në këtë kontekst, Mbrojtja e Thaçit kërkoi leje për apelimin e vendimit bazuar në pyetjen nëse deklaratat e paraqitura gjatë marrjes në pyetje nga pala jothirrëse me të vërtetë duhet të paraqiten sipas rregullave konkrete të Rregullores lidhur me deklaratat me shkrim të dëshmitarëve; nëse Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se kërkesa ishte paraqitur me shumë vonesë; dhe nëse Mbrojtja, sipas udhëzimit të Trupit Gjykses, mund t'i paraqesë deklaratat si prova të veta duke mbajtur parasysht se Mbrojtja nuk mund të thërrasë një dëshmitar që tashmë ka dëshmuar për Prokurorinë.

Trupi Gjykses miratoi kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për apelimin e pikës së parë, konkretisht nëse deklaratat e paraqitura gjatë marrjes në pyetje nga pala jothirrëse duhet të përmbushin kriteret për deklaratat me shkrim të dëshmitarëve. Trupi Gjykses konstatoi se kjo do të ndikonte ndjeshëm në drejtësinë dhe





shpejtësinë e kryerjes së procesit, dhe se marrja e një vendimi lidhur me këtë pikë do të kontribuonte thelbësisht në avancimin e procesit gjyqësor. Kryetarja e Dhomave të Specializuara Ekaterina Trendafilova më 14 gusht caktoi një panel të Gjykatës së Apelit që përbëhet nga gjykatësit Mishelë Pikar, Kai Ambos dhe Nina Jorgensen.

Më 11 gusht, Trupi Gjykses urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Thaçi duke konstatuar se rreziqet që ai mund të pengojë ecurinë e procesit dhe/ose mund të kryejë vepra penale të tjera ende ekzistojnë. Trupi Gjykses theksoi se këto rreziqe ekzistojnë edhe pas përfundimit të paraqitjes së provave prej Prokurorisë sepse shumë prej dëshmitarëve të saj janë nën masa mbrojtëse dhe identitetet e tyre nuk mund të bëheshin publike në atë kohë. Gjithashtu, rreziku i ndërhyrjes përshin edhe tentativë për hakmarrje kundër dëshmitarëve të cilët kanë dëshmuar si edhe tentativë për ndërhyrje ndaj dëshmitarëve në procese paralele. Trupi Gjykses gjithashtu kujtoi se duket se z. Thaçi u dha vizitorëve jo të privilegjuar informacion të marrë gjatë dhënies së dëshmimeve prej dëshmitarëve të mbrojtur dhe se dokumentet tregojnë se ai transmetoi udhëzime lidhur me formën dhe përmbajtjen e dëshmisë së një dëshmitari të thirrur nga Prokuroria. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstatoi se lirimi i z. Thaçi i cili zotëron informacion të ndjeshëm nuk do të kontribuonte në mbrojtjen e efektshme të dëshmitarëve.

Më 13 gusht, Paneli i Apelit rrëzoi apelet e Rexhep Selimit, Kadri Veselit dhe Jakup Krasniqit kundër vendimeve të Trupit Gjykses lidhur me kërkesat e tyre për librim të kushtëzuar. Në lidhje me të tre të akuzuarit, Paneli i Apelit konfirmoi konstatimet e Trupit Gjykses se ende ekziston rrezik që të akuzuarit mund të pengojnë ecurinë e procesit dhe të kryejnë vepra penale të tjera edhe pas përfundimit të paraqitjes së provave prej Prokurorisë, duke mbajtur parasysh se ata mund të hakmerren kundër dëshmitarëve, të tentojnë t'i bëjnë dëshmitarët që të tërheqin dëshmitë ose të tentojnë të ndërhyjnë ndaj dëshmitarëve në procese paralele. Paneli i Apelit konstatoi se ishte e arsyeshme që Trupi Gjykses mori parasysh atmosferën mbizotëruese të ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve në Kosovë. Lidhur me Rexhep Selimin dhe Kadri Veselin, Paneli i Apelit gjithashtu mori parasysh pretendimin se të akuzuarit kishin zbuluar informacion konfidencial për palë të treta të paautorizuara në objektin e paraburgimit.

Më 19 gusht, Trupi Gjykses gjatë konferencës përgatitore për Mbrojtjen caktoi datën për fillimin e paraqitjes së provave të Mbrojtjes më 15 shtator 2025. Gjatë seancës, palët diskutuan tema si kohëzgjatja për dëshmitë e dëshmitarëve, rendi i paraqitjes së dëshmitarëve që do të thirren, nxjerrja e deklaratave të dëshmitarëve dhe numri i provave materiale dhe dokumenteve që Mbrojtja synon të paraqesë.

Kalendari i seancave deri në dhjetor është publikuar në faqen e DHSK-së. Seanca vijuese në këtë çështje gjyqësore është planifikuar më 15 shtator, duke filluar në orën 09:00.

Në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Fadil Fazliut, Isni Kilajt dhe Hajredin Kuçit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake më 24 korrik rrëzoi kërkesat e zotit Thaçi dhe zotit Fazliu për apelimin e Vendimit të Gjykatës së Procedurës Paraprake mbi Mocionet Paraprake që Pretendojnë Mangësi në





Aktakuzë. Dy ekipet e Mbrojtjes argumentuan se Prokuroria nuk kishte paraqitur të dhëna të mjaftueshme në mbështetje të akuzës së tentativës për pengim. Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi se argumentet e Mbrojtjes nuk përbënin pika të apelueshme sepse shtrembëronin vendimin e Gjykatës së Procedurës Paraprake dhe thjesht shprehnin mospajtim me të.

Në një vendim tjetër më 25 korrik në lidhje me hapat vijues në këtë çështje, Gjykatësja e Procedurës Paraprake mori parasysh fazën e avancuar të procesit të nxjerrjes së materialeve dhe urdhëroi Prokurorinë t'i japë asaj informacion lidhur me detyrimet për nxjerrje të materialit ende të panxjerrë dhe kohën kur Prokuroria synon të jetë gati për gjykim, brenda datës 25 gusht. Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëroi ekipet e Mbrojtjes që ta informojnë nëse synojnë të kryejnë hetime ose analiza forenzike të mëtejshme, nëse kanë kundërshtime ndaj provave të nxjerra nga Prokuroria dhe kur parashikojnë të jenë gati për gjykim. Gjykatësja e Procedurës Paraprake caktoi 19 shtatorin si afat që Prokuroria të dorëzojë Dosjen e vet Paraprake dhe 20 tetorin si afat për dorëzimin e Dosjes Paraprake të Mbrojtjes.

Më 25 korrik, Kryetarja e Dhomave të Specializuara Ekaterina Trendafilova caktoi panele të Gjykatës së Apelit për rishikimin e vendimeve të apeluara nga Mbrojtja e Thaçit në lidhje me ndikimin se si faktet e shqyrtuara në procese të tjera do të zbatohen në këtë çështje; nëse Gjykatësja e Procedurës Paraprake duhej të kishte rishikuar ligjshmërinë e emërimeve të veta si Gjykatëse e Procedurës Paraprake dhe Gjykatëse e Vetme; dhe nëse Mbrojtja duhet lejuar të kundërshtojë përmes një mocioni paraprak praktikën e emërimit të të njëjtit gjykatës si Gjykatës i vetëm dhe Gjykatës i Procedurës Paraprake. Të dy panelet përbëhen nga gjykatësit Mishelë Pikar, Emilio Gati dhe Nina Jorgensen.

Në kërkesën për leje për apelimin e dy vendimeve. Mbrojtja e Thaçit gjithashtu kishte kërkuar zgjatje të afatit të dorëzimit të apeleve duke argumentuar se në to ngrihen probleme të rëndësishme që kanë të bëjnë me të drejtat themelore të të akuzuarit. Gjithashtu, Mbrojtja pretendoi se afati bie brenda periudhës së pushimit të gjykatës, periudhë gjatë të cilës Mbrojtja nuk ka personel të mjaftueshëm dhe i duhet të menaxhojë përparësi të ndryshme për përgatitjen e Mbrojtjes në gjykimin *Thaçi dhe të tjerët* për krime lufte. Paneli i Apelit më 28 korrik e miratoi këtë kërkesë pjesërisht dhe zgjati afatin për shqyrtimin e apeleve nga 4 më 18 gusht 2025.

Më 5 gusht Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Hashim Thaçit, Isni Kilajt, Bashkim Smakajt dhe Fadil Fazliut, duke konstatuar se ende ekziston rrezik që të akuzuarit mund të arratisen, të pengojnë procesin dhe/ose të kryejnë vepra penale të tjera. Ajo është bindur se asnjë kusht jashtë objektit të paraburgimit të Dhomave të Specializuara nuk mund të zvogëlojë mjaftueshëm këto rreziqe. Në vendimet e saj, Gjykatësja e |Procedurës paraprake mori parasysh atmosferën mbizotëruese të frikës dhe frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë kundër dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm të Dhomave të Specializuara si dhe akuzat konkrete kundër të akuzuarve.





Paneli i Apelit më 7 gusht rrëzoi apelin e Mbrojtjes së Thaçit lidhur me një mocion paraprak të rrëzuar nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake. Mbrojtja e Thaçit pretendoi se i takonte Trupit Gjykues në çështjen për krime lufte *Thaçi dhe të tjerët* që të trajtonte aktakuzën për mosbindje ndaj gjykatës, jo Gjykatësës së Procedurës Paraprake. Paneli i Apelit e gjykoi mocionin të papranueshëm duke argumentuar se vendimet mbi mocionet paraprake janë të apelueshme vetëm në lidhje me kundërshtimin e juridiksionit të Dhomave të Specializuara, ose mbajtjen në paraburgim.

Më 18 gusht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake miratoi dhe rrëzoi pjesërisht një kërkesë të Prokurorisë për ndalimin e vizitave të personave të caktuar për zotin Thaçi në objektin e paraburgimit. Gjykatësja e Procedurës Paraprake miratoi kërkesën lidhur me persona konkretë, duke konstatuar se masa është e domosdoshme duke marrë parasysh se personat në fjalë dalin në audioincizime të bëra nga Prokuroria më 2023 që tregojnë se z. Thaçi u zbuloi në mënyrë të përsëritur informacion konfidencial vizitorëve të tij.

Sidoqoftë Gjykatësja e Procedurës Paraprake e rrëzoi kërkesën në lidhje me tre vëllezërit e z. Thaçi. Ndonëse Gjykatësja e Procedurës Paraprake theksoi se vëllezërit kishin diskutuar për dëshmitarë të mbrojtur, ndër të tjera edhe se si duhej të dëshmonte një dëshmitar dhe rrjedhimisht ka të ngjarë të kenë marrë pjesë në zbulimin e informacionit konfidencial për palë të treta, ajo gjithashtu kujtoi rëndësinë e ruajtjes së marrëdhënies së ngushtë me familjen dhe pranoi argumentin e Mbrojtjes se tre vëllezërit i japin zotit Thaçi mbështetje morale të vyer. Gjykatësja e Procedurës Paraprake mbajti parasysh se kontakti me familjen është edhe më i rëndësishëm duke qenë se babai i zotit Thaçi u nda nga jeta kohët e fundit.

Gjykatësja e Procedurës Paraprake theksoi se kufizimet e urdhëruara në vendimin e saj duhet të mbeten në fuqi për aq kohë sa i shërbejnë një synimi legjitim dhe vazhdojnë të jenë të domosdoshme dhe proporcionale dhe informoi se do të rishikojë domosdoshmërinë e këtyre masave në çdo tre muaj.

Më 18 gusht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, rrëzoi kërkesën e z. Thaçi për apelimin e vendimit të saj. Gjatë trajtimit të pikave të ngritura në kërkesën e Mbrojtjes, gjykatësja bëri të qartë se kishte vlerësuar si nivelin e rrezikut që paraqiste secili prej vizitorëve ashtu edhe nëse ndalimi i vizitave të këtyre personave ishte i domosdoshëm dhe proporcional, për të zvogëluar rrezikun e zbulimit të paligjshëm të informacionit konfidencial. Ajo arriti në përfundimin se pikat e ngritura nga z. Thaçi nuk ishin të apelueshme dhe se Mbrojtja thjesht shprehte mospajtim me vendimin e saj.

Në çështjen e Pjetër Shalës, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, gjykatëse Ekaterina Trendafilova, më 25 korrik caktoi një panel të Gjykatës Supreme për të vendosur në lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes për Zgjatje të Afatit dhe Shtim të Numrit të Lejuar të Fjalëve në Kërkesën e saj për Mbrojtje të Ligjshmërisë. Z. Shala kishte argumentuar se për shkak të pushimit të gjykatës që shkaktoi probleme lidhur me personelin dhe për arsye se Aktgjykimi i Apelit do të jetë gati në gjuhën shqipe më 12 shtator, nevojitet kohë shtesë për përgatitjen e kërkesës. Paneli i Gjykatës Supreme përbëhet nga gjykatësit Ekaterina Trendafilova, Kristinë van den Vijngaert dhe Daniel Fransen.





Më 8 gusht, Paneli i Gjykatës Supreme rrëzoi kërkesën e z. Shala duke konstatuar se nuk kishte bazë ligjore për ndryshimin e afatit dhe se Mbrojtja nuk kishte provuar se si faktorët e përmendur në kërkesën e saj përligjin një shtim të madh të numrit të lejuar të fjalëve. Paneli theksoi se Aktgjykimi i Apelit u lëshua në anglishte si gjuha e pranuar e punës për procesin gjyqësor dhe se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ka karakter tërësisht juridik. Rrjedhimisht, është përgjegjësi e mbrojtësve të këshillojnë klientin e tyre lidhur me kërkesën.

Më 25 korrik, u publikua një vendim i Gjykatësit të Vetëm i 8 majit ku trajtohet pagimi i zhdëmtimeve në çështjen *Salih Mustafa*. Në vendim Gjykatësi i Vetëm urdhëroi personat ose institucionet e përfshirë në vlerësimin e mjeteve financiare të z. Mustafa të përmbushin urdhrat e tij të mëparshëm dhe t'i japin informacionin e nevojshëm Administratores së Dhomave të Specializuara. Gjykatësi i Vetëm gjithashtu urdhëroi Administratoren të paraqesë një raport të gjerë lidhur me mjetet financiare të z. Mustafa jo më vonë se 25 qershor 2025. Gjykatësi i Vetëm nënvizoi se në lidhje me këtë pikë duhet arritur në një përfundim sa më shpejt që të jetë e realizueshme, me qëllim që Administratorja dhe Mbrojtja e Viktimave të mund të kërkojnë kompensim nga Programi për Kompensim i Viktimave të Krimeve në Kosovë, në qoftë se rezulton se mjetet aktuale në zotërim të z. Mustafa nuk mundësojnë zbatim të plotë të urdhrat për zhdëmtim brenda një kohe të arsyeshme.

Më 11 gusht, Gjykatësi i Vetëm miratoi lejen për z. Mustafa për apelimin e një vendimi të 16 korrikut në të cilin Gjykatësi kishte urdhëruar zotin Mustafa të paguante një kamatë vjetore prej 8% mbi shumën ende të papaguar të zhdëmtimeve. Gjykatësi i Vetëm konstatoi se ky problem ndikon në drejtësinë dhe shpejtësinë e procedurës së zhdëmtimit dhe se një vendim do të kontribuonte thelbësisht në avancimin e kësaj procedure. Më 14 gusht, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, gjykatëse Ekaterina Trendafilova, caktoi një panel të Gjykatës Supreme për të vendosur në lidhje me këtë problem. Paneli i Apelit përbëhet nga gjykatësit Mishelë Pikar, Kai Ambos dhe Nina Jorgensen.

